

Hapet Thirrja për Mobilitete (Bursa) studentësh të UPT-së, në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në Universitetin Shkencave të Aplikuara në Anhalt, (Gjermani).

Në kuadër të marrëveshjes bilaterale, Erasmus + Programe Key Action 1,
ndërmjet Universitetit të Shkencave të Aplikuara të Anhalt (Gjermani)
dhe Universitetit Politeknik të Tiranës, hapet thirrja për aplikime në:

- Bursa studimore pranë Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Anhalt (Gjermani), të financuara nga programi Erasmus + KA1.
- Për studentë, 4 studente * (kohezgjatja 4,5 muaj)
- Fusha e studimit
 - Arkitekturë (2 studentë)**
 - Arkitektura e pejsazhit (2 studentë)***
- Periudha brenda së cilës vendoset bursa studimore: semestri dytë 1.04.2021-30.9.2021
- Gjuha e huaj, Anglisht ose Gjermanisht (niveli B2)

* Info për studentët: www.hs-anhalt.de/en/international/studyexchange-and-internship-abroad/erasmus-incoming-stdudents.html

*Info për studimet: www.hs-anhalt.de/nc/studieren/orientierung/studienangebot.html

**Info për studimet në Master të Arkitekturës mund të gjeni në: <https://www.hs-anhalt.de/nc/en/study/orientation/study-guide/detail/architecture-dia-master-of-arts.html>

***Info për studimet në Master të Arkitekturës së pejsazhit mund të gjeni në: www.hs-anhalt.de/nc/studieren/orientierung/studienangebot/detail/landscape-architecture-master-of-arts.html

Dokumentat e nevojshme për aplikim:

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj¹
- Dokumenti Learning Agreement²

¹ Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze dhe në gjuhën gjermane, ku niveli minimal i kërkuar për të dyja gjuhët është B2. Nëse do të përzgjidhen lëndë që zhvillohen në të dyja gjuhët, studenti duhet të plotësojë nivelin minimal të kërkuar për të dyja këto gjuhë duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

² Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Përcaktimi i lëndëve për tu ndjekur do të bëhet me propozim nga aplikanti dhe aprovim nga Drejtuesi i Departamentit që drejton Programin e Studimit. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë "Mobility Plan". Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin

Afati për aplikim: deri më 25 Nëntor 2020 ora 13.00

Dokumentacioni dorëzohet pranë Sekretarisë në FAU

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universitetin Politeknik të Milanos lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t'ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ata që do të zhvillonit në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Arkitekturës e Urbanistikës.

Dokumenti "Learning Agreement" tek seksioni "Commitment" firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i Fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë.

Për të shkarkuar formatin e "Learning Agreement" klikoni si më poshtë:

https://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/resources/documents/applicants/learning-agreement_en

pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakultetin e Arkitekturës e Urbanistikës kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.